

**2 Rritja e pagës në skelari**  
Nga 1 prilli 2019 rritje e përgjithshme e pagave

**3 Greva e grave dhe migrantet Stop**  
diskriminimit të dyfishtë!

**4 Demonstrata e Bashkimit të Sindikatave Evropiane**  
Për një Evropë më të drejtë dhe më sociale!

Nr. 3 | maj 2019 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

## Marrëveshja kornizë me BE-në Po lëvizjes së lirë të personave, po mbrojtjes së pagave



Solidarizimi i sindikalistëve zviceranë me demonstratën e Bashkimit të Sindikatave të Evropës para Komisionit Evropian me 26 prill 2019 në Bruksel

**Lëvizja e lirë e personave me BE-në për punëdhënësit ka qenë një përparim i rëndësishëm, i cili u ka dhënë atyre më shumë të drejta. Mirëpo, kjo duhet të ndërlihet me mbrojtje efikase të pagave. Marrëveshja e paraqitur kornizë me BE-në tenton të tërheqë mbrojtjen e pagave – Unia kundërshton diçka të tillë.**

Lëvizja e lirë me BE-në, e cila vlen nga viti 2002, ka fuqizuar të drejtat e punëdhënëseve. Më herët ishte statusi jo njerëzor i stinorëve. Shfrytëzimi i stinorëve, të cilët ishin të detyruar të punonin për paga të ulëta dhe pa asnjë siguri, shtypte gjithë nivelin e pagave. Lëvizja e lirë e personave i dhe fund këtij kapitulli të errët. Kjo është bazamenti për më shumë dhe për të drejta të njëjta për të gjithë punëmarrësit.

### Masat mbrojtëse: Mbrojtje e pagave

Bashkë me lëvizjen e lirë të personave, sindikatat zbatuan edhe masat mbrojtëse. Masat mbrojtëse konkretisht janë: Kontrata të mira Kolektive të Punës, më shumë paga minimale të detyrueshme dhe kontrolle vjetore të së paku 45000 firmave. Me këtë rast janë zbuluar me mijëra shkelje: Gati ¼ e firmave është dashur të korrigojnë pagat tejet të ulëta. Pra, masat mbrojtëse janë mjete efikase për mbrojtjen e pagave.

### Mbrojtja e pagave është domosdoshmëri

Nuk ka alternativë sa i përket

mbrojtjes efikase të pagave: Statutet diskriminuese për të huajt, apo fleksibilizimi i tërësishëm i kushteve të punës qojnë në shtypje më të madhe të pagave, në më shumë shfrytëzim dhe punë në të zezë. Edhe për BE-në deri më tani ishte e qartë, që nivelit të lartë të pagave të Zvicrës ka nevojë për një mbrojtje të veçantë.

### InstA donë të reduktojë masat mbrojtëse

Propozimi i prezantuar mbi marrëveshjen e institucionalizuar kornizë (InstA) synon ti jep përparësi «qasjes së tregut» dhe interesave të ndërmarrjeve dërguese. Masat e deritashme mbrojtëse të rregulluara nga Zvicra, rishtas u nënshtrohen rregullave të BE-së – me pasojë mëdha:

- Kërcënon një reduktim masiv i numrit të kontrolleve veçanërisht në rrafshin e të dërguarve dhe tek të vetëpunësuarit e rremë.
- Kontrollat vështirësohen përmes kohës së shkurtër parajmëruese për ndërmarrjet dërguese.
- Depozitat dhe me këtë edhe gjatë efikase nuk do të lejohen më

për shumicën e firmave që bëjnë shkelje.

■ Do të kufizoheshin bllokimet dhe sanksionet e organeve kontroluese të paritetit.

■ Masat e reja mbrojtëse nuk do të ishin më të mundshme, pasi mosmarrëveshjet do të zgjidheshin bazuar në direktivat e BE-së dhe Gjykatën Evropiane të Drejtësisë.

### Të gjithë punëmarrësit humbin

Më këtë lloj marrëveshjeje kornizë do të humbnin të gjithë punëmarrësit. Fillimisht të 240000 veta me qëndrim të shkurtër, kryesisht nga hapësira e BE-së, kushtet e pagesës të të cilëve nuk do të mund të mbroheshin më tej. Mirëpo edhe të kolegeve/ëve të tyre me qëndrim të cilëve gjithashtu do ti nënshtroheshin presionit. Dhe në rast kur Gjykata Evropiane e Drejtësisë pengon zbatimin e KKP-ve dhe e trazon gjithë sistemin e pagave, kjo do të ketë pasojë të paparashikueshme për të gjithë punëmarrësit.

### Për një Zvicër të hapur në një Evropë sociale

Hapja e tregut evropian të punës

nuk duhet të degjenerojë në një kalim të lirë për bizneset për të shfrytëzuar punën dhe për të zvogëluar pagat. Të drejtat e fuqishme dhe të barabarta të punonjësve duhet ta kundërshtojnë këtë. Përndryshe, do të përgatitet terreni për ksenofobi, diskriminim dhe nacionalizëm tru-ngushtë. Ne nuk duam këtë. Përkundrazi: ne angazhohemi për një Zvicër të hapur në një Evropë sociale.

### Të mbrojmë lëvizjen e lirë të personave dhe pagat

Unia dëshiron një mbrojtje të fortë të pagave dhe kushteve të punës dhe kundërshton çdo lloj diskriminimi, në mënyrë që të ruajmë lëvizjen e lirë të personave në Evropë. Megjithatë, lufta e ardhshme e referendumit kundër nismës së SVP për heqjen e lëvizjes së lirë të personave, në të cilën është në rrezik gjithë marrëdhënia me BE-në, nuk do të mund të fitohet, nëse mbrojtja e pagave në Zvicër dobësohet nga një marrëveshje e dështuar kornizë me BE-në.

Philipp Zimmermann,  
zëdhënës | Komunikim & Fushata

### Editorial



### Lëvizja e lirë e personave dhe mbrojtja e pagave shkojnë bashkë!

Lëvizja e lirë e personave dhe mbrojtja efikase e pagave shkojnë pandashëm bashkë. Bashkë këto paraqesin një përparim social për Zvicrën. Propozimi i prezantuar mbi marrëveshjen e institucionalizuar kornizë me BE-në e rrezikon këtë të arritur: I jep përparësi «qasjes së tregut» për ndërmarrjet kundrejt të drejtave të punëmarrësve.

Konkretisht kërcënon një reduktim i numrit të kontrolleve veçanërisht në rrafshin e të dërguarve dhe tek të vetëpunësuarit e rremë. Gjatë efikase dhe sanksionet tjera kundër firmave që bëjnë shkelje do të kufizoheshin së tepërmi.

Në të ardhmen do të duhej Gjykata Evropiane e Drejtësisë të vendosë, se cilat masa mbrojtëse të pagave mund të vejë Zvicra. Përmirësimet nuk do të mund të ishin më të mundshme, edhe kur kemi parasysh nevojën urgjente të përmirësimeve shkaku i dumpingut të pagave në rritje. Kështu rrezikohet i tërë sistemi partneritetit kontraktues dhe kontrollues i Zvicrës.

Humbës do të ishin të gjithë punëmarrësit. Fillimisht ata me qëndrim të shkurtër, pagat e të cilëve nuk do të mund të mbroheshin më tej. Pastaj edhe të kolegeve/ëve të tyre me qëndrim të përhershëm që punojnë në degët e rrezikuara. Kësaj do ti gëzoheshin vetëm ndërmarrjet që dërgojnë punëmarrës dhe përfituesit vendor që shkelin pagat. Politikisht përfiton SVP/UDC-ja: Ajo edhe ashtu është kundër të drejtave të punëmarrësve dhe kontrolleve të tregut të punës. Propozimi i keq i marrëveshjes i konvenon pikërisht tani asaj, që edhe më tej ti stigmatizoi migrantet/ët e ti fajësojë ata për presion të pagave. Një teposhtë kjo për iniciativën e rrezikshme anuluese të SVP/UDS, e cila donë të anulojë lëvizjen e lirë të personave!

Këtë ne nuk mund ta lejojmë. Zvicra dhe BE-ja kanë merituar një marrëveshje më të mirë.

Vania Alleva

## News

**Peticion i degës së sigurisë private: janë grumbulluar më shumë se 1000 nënshkrime**

Anëtarët e Unia nga dega e sigurisë private kanë grumbulluar më shumë se 1000 nënshkrime për më shumë mbrojtje nga dumpingu në paga dhe orët e orarin e tepërt të punës. Duke pas parasysh ripërtëritjen e KKP të degës, rezultati i petitionit iu është dorëzuar shoqatës së ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime të sigurisë (VSSU). Për të shmangur një gjendje pa kontratë, menjëherë pas dorëzimit, sindikata ftoi për bisedime urgjente. Punëdhënësit këtë pranverë duhet të kenë veshët e hapur për kërkesat e punonjësve të sigurisë! Partnerët socialë duhet që këtë pranverë të gjejnë një zgjidhje për punonjësit.

**Bisedimet për KKP në kopshtari: Kopshtaret/ët kërkojnë kushte korrekte të punës për gjithë Zvicrën!**

Aktualisht në regjione të veçanta ka (KKP) Kontrata të mira Kolektive të Punës me vlefshmëri të përgjithshme. Për shumicën e Zvicrës gjermane ekziston mjerisht një Kontratë Kolektive Pune jo e detyrueshme, e cila ka mbetur dukshëm mbrapa të gjitha degëve tjera artizanale: paga të ulët, pak pushime vjetore dhe pa mundësi për pensionim të mëhershëm. Aktualisht është duke u ri negociuar KKP-ja përtej regjionale jo e detyrueshme për pjesët tjera të Zvicrës. Konferenca e kopshtarëve të Unia fton shoqatën e punëdhënëseve «JardinSuisse» të ulët me sindikatën në tryezën e bisedimeve dhe të fuqizojnë kushtet e mira dhe të vlefshme të punës. Nga kjo nuk përfitojnë vetëm kopshtaret/ët, por edhe të gjitha firmat serioze.

**Arka e sigurimit të papunësisë Unia merr çmimin «Committed to Excellence» (EFQM)**

Me 20 mars Arka e sigurimit të papunësisë së Unia ka marrë certifikimin «Committed to Excellence». Ajo është Arka e parë e sigurimit të papunësisë në Zvicër që merr një çmim të tillë. Krahas certifikatës, një rol të rëndësishëm luajnë edhe vet projektet përmirësuese që ajo zbaton. Këto projekte ndihmojnë për ta fuqizuar Arkën e sigurimit të papunësisë së Unia për të ardhmen. Modeli i EFQM Excellence i certifikon organizatat, të cilat në kuadër të një procesi të jashtëm provues mund të tregojnë, që ajo kujdeset dhe angazhohet në mënyrë sistematike dhe konsekuente për zhvillimin dhe sigurinë e cilësisë. Arka e sigurimit të papunësisë së Unia pat vendosur para më shumë se një viti që të ballafaqohet me modelin e EFQM-së dhe ka pranuar që të vlerësohet nga një auditor i EFMQ-së.

**Skelaria Rritja e merituar e pagës në skelari nga 1 prilli**

Rreth 2850 punëtorë skelarie nga 1 prilli marrin një rritje të përgjithshme pagash. Pos tjerash do të rriten edhe pagat e tyre minimale. Këto ata i kanë merituar. Unia ka kohë që angazhohet për kushte të mira pune në skelari ndër-timtarie. Kështu që nga 2015 – sikur në foto – me një aksion për rritje korrekte të pagave.



Pamje nga protesta e punëtorëve të skelarisë për rritje pagash

Në përgjithësi shumica e rritjes së pagave është 50 franga në muaj, bazuar në të ardhurat e 31 marsit 2018. Tek pagat minimale për punonjësit e skelarisë pa

njohuri profesionale do të ketë 100 franga me shumë (rishtas 4293 franga) dhe për drejtues grupi skelarie me certifikatë 78 franga (rishtas 5160 franga).

Rritja e pagave ka hyrë në fuqi me 1 prill 2019 dhe janë të obligueshme për të gjitha ndërmarrjet, të cilat marrin me skelari. Këto paga vlejnë dhe për firmat e huaja, të cilat angazhojnë punëtorë skelarie në Zvicër, si dhe për punëtorë temporalë.

**Një sinjal edhe për degët tjera**

Skelaria po prinë: Dega e skelarisë i ka punët mirë dhe nga kjo mund të përfitojnë edhe punonjësit. Ky është një sinjal për degët tjera: ato duhet të ndjekin këtë shembull të rritjes së pagave! Ekonomia është duke u zhvilluar mirë, ndërsa shtrenjtimi po rritet. Punëmarrësit duhet gjithandej të përfitojnë nga prodhimtaria dhe fitimi, ndërsa ndërmarrjet duhet të kujdesen që shtrenjtimi të mos gllabëroj rritjen e pagave.

Marrë nga ueb faqja e Unia dhe adoptuar nga O. Osman

**Konferenca e migracionit e BSZ-së e 30 marsit 2019 Politika e migracionit dhe lëvizja e lirë e personave – vizionet sindikaliste**

Rreth 50 sindikaliste/ë në Konferencën e migracionit të Bashkimit të Sindikatave të Zvicrës diskutuan në Bernë për politika migracioni korrekte dhe të denja njerëzore. Për ata është e qartë: Zvicra është një vend migracioni dhe kjo është mirë kështu..

Tri referate fillestare u kujdesen për të përgatitur terrenin për debatin: Patrick Kury (Universiteti i Luzernit) tregoi se Zvicra edhe historikisht është një vend migracioni, ndërsa Geert van Dok (Helvetas) vuri politikën aktuale zvicerane të migracionit në një kontekst ndërkom-bëtar, kurse Nina Vladovic (VPOD) u morr me iniciativën anuluese të SVP/UDC-së dhe me marrëveshjen kornizë me BE-në, si dy sfida aktuale sindikaliste që kanë të bëjnë me politikën e migracionit.

**Orientimi në kartën e OKB-së dhe konventën për të drejtat e njeriut**

Pjesëmarrësit/it e konferencës së migracionit të BSZ-së janë të bindur, se politikën e migracionit të sindikatave duhet të orientohen në të arriturat shoqërore si Karta e Kombeve të Bashkuara dhe në Konventën mbi të Drejtat e Njeriut. Ata u deklaruan për një politikë korrekte të migracionit, e cila respekton

të drejtat dhe dinjitetin e njerëzve, që bazohet në shtetin ligjor dhe të drejtat njerëzore si dhe që lufton shkaqet e ikjes, si dhuna, konfliktet dhe fatkeqësitë e pa frenuara klimatike e mjedisore. Diskursit ksenofob, të cilin na e imponojnë, ne duhet ti përgjigjemi e ti kundërvihemi me solidarizim, i cili duhet të shkojë përtej kufijve të Zvicrës.

**Zvicra është vend migracioni**

Ky diskurs që paraqet migracionin si problem, e fsheh faktin se Zvicra ka kohë që është një vend migracioni. Në shekullin e 19të një e treta e popullsisë zvicerane ka migruar – një gjysmë milioni përtej oqeanit, ndërsa një gjysmë milioni tjetër në vendet fqinje. Shumë zviceran/e kanë kërkuar mbrojtje dhe një të ardhme më të mirë dhe e kanë gjetur atë. Mbrojtje dhe perspektivë për të ardhmen u ka ofruar Zvicra ardhacakëve të cilët në ndërrimin e shekujve për herë të parë numerikisht ka tejka-

luar emigrimet zvicerane – ndër të tjera edhe për shkak të rolit prijës të Zvicrës sa i përket studimit të grave. Tek nga lufta e parë botërore politika zvicerane e migracionit është bërë represive. Ky zhvillim ka arritur pikën më të lartë në vitet e 70ta si dhe aktualisht.

**Për një Evropë sociale dhe solidare: Mbrojtja e lëvizjes së lirë të personave dhe mbrojtja e pagave**

Fjala përfundimtare e nënkrytares së BSZ-së Vania Allea e përkufizon: Zvicra është vend migracioni dhe kjo është me shumë vlerë. Andaj ne na duhet ato – pasi njëra nuk funksionon pa tjetrën. Të gjithë ne bashkë duhet me gjithë forcat tona të luftojmë iniciativën e SVP/UDC-së që synon anulimin e lëvizjes së lirë të personave – dhe që të angazhohemi për një Evropë sociale dhe solidare.

Regula Bühlmann, SGB-Zentralsekretärin (adoptiert durch O. Osman)



Pamje nga punimet e Konferencës së Migracionit të Bashkimit të Sindikatave të Zvicrës

# Migrantet marrin pjesë në grevën e grave Stop diskriminimit të dyfishtë – Të njihen diplomat e huaja

Në gjithë botën migrojnë më shumë gra se sa burra. Shkaku i kushteve të pabarabarta në tregun e punës dhe pabarazisë së ai përket qasjes tek resurset bëhet fjalë për feminizmin e varfërisë. Të jesh grua dhe e huaj qon në përjashtime specifike.

Migrantet në botën e punës shpesh përballen me situata të vështira si gra dhe si të huaja. Ato i nënshtrohen diskriminimit të dyfishtë, qoftë si gra, apo si migrante.

Yvonne Riaño dhe Nadia Baghdadi në vitin 2004 kanë hulumtuar integrimin e migraanteve të kualifikuara nga Ame-

rika latine dhe hapësirat myslimane dhe kanë në përfundimet vijuese:

- Më shumë se një e treta (37%) nuk janë në marrëdhënie pune
  - Gati në e treta (27%) kryejnë punë nën kualifikimin që kanë
  - Gati një e treta punojnë në përputhje me kualifikimet e tyre, mirëpo në kushte të këqija dhe të pasigurta pune
  - 10% punojnë në përputhje me kualifikimet e tyre në marrëdhënie të sigurta pune.
  - Të gjitha të punësuarat punojnë me orar të pjesshëm pune dhe me pak përjashtime kryesisht me kontratë të kufizuar pune
- Shumica e migraanteve ose janë të përjashtuara nga tregu i punës ose punojnë nën përgatitjen e tyre kualifikuese, apo kanë punë të pasigurtë. Shpesh ato janë të punësuarat në degët me paga tejet të

ulëta, si gastronomi, pastrim, shitje dhe në amvisnit private. Pos kësaj shkollimet dhe diplomat e migraanteve në Zvicër shpesh nuk janë të pranuar. Andaj shumë migraante të kualifikuara janë të detyruar atë pranojnë punë nën kualifikimet e tyre profesionale.

Migrantet janë të prekura në numër jo proporcional nga papunësia dhe varfëria, apo edhe kur janë të punësuarat atëherë në sektorët me paga tejet të ulëta. Për këto shkaqe migrantet kanë më shumë arsye për të bë grevë. Ne do të marrim pjesë aktivisht në grevën e grave. Duhet të pësojnë edhe ndryshimet vijuese: Në të gjitha lëmit e jetës shoqërore duhet dhënë fund ligjeve dhe praktikave të cilat diskriminojnë gratë dhe migrantet.



Emine Sariasslan

## Proncimi i aktivistes të gjuhës turke

Unë marrë pjesë në grevën e grave pasi unë dua të drejta të njëjta për gratë. Pagat e shumë grave nuk mjaftojnë për të bërë një jetë me dinjitet. Edhe pse gratë kryejnë punë të njëjtë, ato marrin pagë më të ulët, se sa burrat. Ne punojmë, kryejmë shumë punë shtëpie, kujdesemi për fëmijët tanë, mirëpo puna jonë dhe kontributi jonë nuk respektohen. Gratë nuk kanë thuaja se fare kohë për tu trajnuar më tej dhe për perspektiven e tyre profesionale dhe personale. Andaj shpesh burrat janë në pozita drejtuese. Në shoqëri zotëron një politik diskriminuese e seksiste. Ndër të tjera ne si migraante i nënshtrohemi diskriminimit të dyfishtë. Këtë ne duam ta ndryshojmë! Andaj ne do bëjmë grevë si gra, si migraante. Ne duam të ndryshojmë shoqërinë!

Hülya Genis, kryetare e grupit të grave të Unia në Bernë



Gratë kërkojnë respekt, më shumë pagë dhe më shumë kohë

# Ti japim fund pabarazisë në paga

Që nga viti i kaluar është e qartë: Gratë duan grevë. Pas revidimit të ligjit më shumë se sa të pakënaqshëm me nenin e tëholluar mbi barazinë në paga dhe stagnimin e përgjithshëm kur është fjala për barazinë gjinore është mbushur kupa. Në ndërkohë shumëçka është vënë në lëvizje. Në të gjitha regjionet e Zvicrës janë formuar kolektive lokale dhe në disa vende edhe më shumë se sa një. Kështu fjala bie në regjionin Appenzell në kohën e fundit edhe një kolektiv. Një shembull tjetër është grupi i grave të Entit Federal për statistika, i cili për çdo javë bënë publik statistikat e raja mbi pabarazinë mes burrave dhe grave. Kolektivet lokale takohen rregullisht dhe planifikojnë gjithçka rreth 14 qershorit. Paralelisht me këtë zhvillohen manifestime tjera të ndryshme të komiteteve,

në të cilat në qendër të vëmendjes janë shkëmbimet dhe rrjetëzimet e grave. Aktivitetet e reja feministë nëpër kantone hasin në jehonë të madhe dhe lëvizja sa vjen e rritet. Gjithmonë më shumë gra i bashkangjiten lëvizjes dinamike. Mirëpo lëvizja nuk gjallëron vetëm në kolektive, por edhe në iniciativa e aksione të shumta individuale. Kështu fjala bie gratë nga vendbanimet rurale janë bashkuar dhe me 7 qershor do të nderin zjarre të larta.

### Aksionet në ndërmarrje

Paralelisht me këtë është duke u bërë edhe mobilizimi nëpër ndërmarrje. Unia është duke shkuar nëpër ndërmarrje dhe duke informuar gratë mbi grevën e grave. Gjithnjë e më shumë gra janë duke u bashkangjitur dhe gjithnjë

e më shumë burra janë duke treguar fotot me proncime nga ndërmarrjet. Bashkërisht që të gjithë kërkojnë: «Respekt – pagë më shumë – kohë më shumë!». Ne edhe në javët e ardhshme do të jemi prezent nëpër ndërmarrje. Pasi qëllimi ynë është që me 14 qershor bashkë edhe me ju të zhvillojmë aktivitetet të ndryshme nëpër ndërmarrje. Për këtë kemi nevojë për ju dhe mbështetjen Tënde: Po deshe ta dish Ti se si mund të marrësh pjesë në grevë me 14 qershor, lajmërohu tek regjioni Yt! Bashkërisht mund të vejmë një shenjë për më shumë pagë, më shumë kohë dhe respekt.

Virginia Köpfl, fushata greva e grave

## Portret dhe proncimi: Remzije Rashiti

Remzije Rashiti vjen nga qyteti i Gjilanit dhe që nga viti 1992 jeton në Zvicër. Ajo ka punuar në profesione të ndryshme, ndërsa aktualisht punon si shitëse.

Remzija ka rreth dy vite e gjysmë që është njoftuar për ekzistimin e aktivistëve shqiptarë dhe kjo ka shërbyer si shkas që edhe ajo të anëtarësohet në sindikates Unia. Në këtë grup aktivistësh ka njoftuar shumë shoqe e shokë të tjerë, përmes të cilëve ka mësuar për mundësitë e ndryshme të angazhimit. Menjëherë pas aktivizimit në grupin e aktivistëve shqiptar, ajo është inkuadruar aktivisht edhe në grupin e interesit të migracionit. Nga kjo strukturë sindikaliste, Remzija është zgjedhur si anëtare e kryesisë së Unia për regjionin Cyrih-Shafhauzen. Po ashtu ajo është edhe delegate e regjionit Cyrih-Shafhauzen në organet qendrore të sindikatës Unia.

Në kuadër të sindikatës Unia Remzija përpos angazhimit në aktivitete e aksione të ndryshme ka ndjekur seminare e trajnime si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë gjermane. Këto angazhime dhe seminare kanë kontribuar që Remzija të marrë njohurit e duhura për tu bërë një sindikaliste vërtetë aktive. Ajo është e bindur se organizimi sindikal përpos që ofron mundësi të shumta për të krijuar kushte më të mira pune, ndër të tjera mundëson edhe angazhim e aktivitete për barazi gjinore e për të drejtat e gruas, gjë që prek atë si punëmarrëse dhe edhe si grua.



Remzije Rashiti në demonstratën e Brukselit

### Proncimi i Remzijos:

«Në vendin e punës vërejtë padrejtësi e diskriminim të dyfishtë: në njërin anë si grua e paguar më pak, ndërsa në anën tjetër për shkak të prejardhjes e diskriminuar edhe si migraante. Ky diskriminim prek edhe shumë kolege tjera përreth si dhe në përgjithësi miliona gra gjithandej.» Për shkak të mosnjohjes së diplomave dhe aftësive e kualifikimeve që unë kam pruar me veti si migraante, është e natyrshme që më është dashur të punoi në degë të ndryshme. Sidoqoftë, angazhimi aktiv në sindikatën Unia më bënë të ndihem krenare që jam aktiviste e grupit shqiptarë në kuadër të sindikatës Unia.»


Osman Osmani



## Ju pyesni, Unia përgjigjet

### Divorci: çka ndodh me kontributet e AHV/IV / AVS/AI?

Unë dhe burri im kemi qenë të martuar për shumë vite dhe dukur u ndamë. Të dy ne jemi në marrëdhënie pune. Si duket kontributet nga shtylla e parë e sigurimeve shoqërore me rastin e divorcit çahen. A qëndron kjo dhe çka domethënë kjo?



**Philip Thomas:** Po, kjo qëndron. Kontributet e paguara gjatë bashkëshortësisë me rastin e divorcit ndahen në dy bashkëshortët – në rast se kanë qenë më shumë se një vit të martuar. Kjo lloj ndarje quhet ndarje e të ardhurave apo çarje i të ardhurave. Për ndarjen e të ardhurave vlejën vetëm vitet, në të cilat të dy bashkëshortët kanë qenë të siguruar tek AHV/IV / AVS/AI. Të ardhurat, të cilat janë arritur në vitin e martesës dhe në atë të divorcit nuk ndahen. Çarja e të ardhurave do të duhej ta kërkonte qysh në fillimin e procesit të divorcit. Ndarja e kontributeve është e rregulluar me ligj. Kjo nuk mund të tejkalohet as edhe me kontratë bashkëshortësh.

Work, 29.3.2019

### Puna në shtëpi (Homeoffice): A duhet të jem gjithnjë i arritshëm?

Një ditë në javë unë punoj nga shtëpia. Kjo më konvenon, pasi unë kam një rrugëtim të gjatë për tek vendi i punës. Mirëpo, rishtas shefja ime kërkon që unë të jem arritshëm edhe natën gjatë ditës në të cilën unë i kryej shërbimet e punës në shtëpi si dhe që kah ora 21 të kontrollojë emailat e mi. Unë jam përndryshe mjaft fleksibël gjatë ditës dhe ndërmjet tjetra mund të kryej edhe punë e mija private, për çka edhe pritshmëria për të qenë i arritshëm edhe në mbrëmje pas orarit të punës paraqet një kundërshërbim korrekt. Megjithatë, unë dua të kryej orarin e punës dhe të jem i lirë në mbrëmje në rastet kur unë kam punuar gjatë gjithë orarit të punëve të zyrës edhe në shtëpi. Nëse unë nuk e di se mos edhe gjatë darkës marrë ndonjë telefonatë, apo nëse unë duhet të përgjigjem ndonjë email, atëherë unë nuk mund të jem i lirë dhe i rehatuar. A duhet në të vërtetë të jem unë i arritshëm edhe deri vonë në mbrëmje?

**Mirjam Brunner:** Jo. Ju edhe gjatë kryerjes së punëve të zyrës nga shtëpia (Homeoffice) keni të drejtë në përfundimin e ararit të punës dhe kohën e lirë. Në Homeoffice vlejën të njëjtat rregulla sikur edhe në zyrë. Kur sipas rregullit punoni orarin e punës në zyrë, atëherë kjo vlen njëjtë edhe për Homeoffice. Pa ndonjë arsye të veçantë shefja juaj nuk mund të kërkojë që edhe pas orarit të punës që vlen në zyrë, të jeni prapë i arritshëm. Edhe në Homeoffice është me rëndësi të veçantë që të ndahet orari i punës dhe koha e lirë pas orarit zyrtar. Nëse orari i punës stërgjatët edhe deri vonë në mbrëmje, ekziston reziku i mos përfundimit të punës gjatë gjithë kohës. Kjo mund të qojë deri edhe tek pengesat në gjumë. Andaj edhe për shkaqe shëndetësore është me rëndësi dhe kuptimplotë, që të kundërshtoni pritshmërinë të jeni gjithmonë i arritshëm.

Work, 12.4.2019

## Delegacioni zviceran në demonstratë sindikaliste evropiane Për një Evropë korrekte dhe sociale

Bashkimi Evropian dhe instancat e tij duhet që interesat e punëmarrësve ti vejnë në qendër të politikave të tyre. Këtë kërkuan mbi 8000 sindikaliste sindikalistë me demonstratën e tyre shumëngjyrëshe, paqësore, të hareshëm dhe fuqplotë me 26 prill 2019 në Bruksel.

Demonstratën e kishte ftuar Bashkimi i Sindikatave Evropiane (EGB/CES). Sekretari gjeneral Luca Visentini kërkoi nga të gjithë qytetaret/ët e BE-së që me rastin e zgjedhjeve «të votojnë për kandidatët dhe partitë, të cilat do të angazhohen për një Evropë korrekte dhe për punëmarrësit»:

Për një politikë për të gjithë Bashkë me koleget dhe kolegët nga Belgjika, Italia, Franca, Spanja, Gjermania, Hungaria, Sllovenia, Austria dhe Estlanda, edhe delegacioni që ka udhëtuar nga Zvicra kërkoi një Evropë më të mirë dhe më sociale, përparim shoqëror, paga më të mira si dhe kushte më të mira pune dhe jetese, shkurt: për një

politikë, e cila nuk i venë në qendër të vëmendjes përfituesit, por shumicën.

### Zviceranët kërkojnë «Mbrojtje pagash në vend të kufijve»

Në qendër të kërkesave zvicerane, ishte logjikisht marrëveshja kornizë Zvicër-BE bashkë me të gjitha sulmet kundër sulmeve në pagat e mbrojtura dhe masave tjera mbrojtëse. Për mes kërkesës së vendosur në transparentin frontal «Të mbrojmë pagat në vend të kufijve – për një Evropë sociale» delegacioni i Zvicrës hasi në aprovim dhe vëmendje të madh, sikur tek kolegët sindikalistë ashtu edhe tek mediat.

Veçanërisht të kënaqur u treguan sindikalistët e sindikalistët nga Zvicra. Pjesëmarrja e tyre nga një vend jo i BE-së e kuptuan në një mënyrë si akt solidariteti me sindikatën simotra të BE-së. Në anën tjetër për ta është e qartë se ligje dhe rregullat e BE-së i prekin drejtpërdrejt edhe të drejtat e punëmarrësve në Zvicër, dhe atë jo vetëm sa i përket marrëveshjes kornizë. Në këtë kontekst delegacioni zviceran shfaqte bindjen përmes pllakatit: «Social në vend se kombëtar: Kështu ka të ardhme Evropa»

Marília Mendes / Matthias Preisser

## 1-Maji 2019 në Prishtinë

Protestës së BSPK-së iu janë bashkuar edhe dhjetëra qytetarë, të cilët kërkuan punë dhe paga të dinjitetshme dhe siguri dhe shëndet në punë, nëpërmjet një marshi nga sheshi «Zahir Pajaziti» deri në sheshin «Skënderbeu».



Kryetari i BSPK-se, Avni Ajdini, tha se padrejtësitë ndaj punëtorëve në Kosovë janë të mëdha, që nga orari i zgjatur i punës deri në 16 orë e paga jo e dinjitetshme. Ajdini bëri thirrje nga protesta që të rritet paga minimale. «Edhe pse paga minimale është nënshkruar dhe është zotuar më 28 dhjetor 2017, ajo ka vlerë për vitin 2018, kurse unë sot them këtu që, ajo pagë minimale nuk është 150 më, por ajo pagë minimale do të jetë 300 euro, sepse shporta e qytetarit, shporta e punëtorit, është ngritur», tha Ajdini. Përveç pagës së ulët, Ajdini ka shprehur shqetësim edhe për numrin e vdekjeve në vendin e punës, por edhe trajtimin e pensionistëve me skemat aktuale pensionale. Në protestë u kërku nga institucionet që t'i marrin parasysh kërkesat e sindikalistëve, në të kundërtën do të ballafaqohen me protesta masive.

### Solidaritëti i sindikalistëve nga Zvicra

Pjesë e kësaj proteste kishte mysafir dhe nga shtete e huaja. Asaj i është bashkuar edhe sindikata Zvicerane UNIA. Përfaqësuesi nga sindikata e punëtorëve Unia të Zvicrës, Mattia Lento, përmendi kushtet e vështira të punëtorëve të huaj në Zvicër, përfshirë ata kosovarë, fjala bie me diskriminimin të pashembullt nga fusha e sigurimeve shoqërore. Sindikalistët nga Zvicra u shprehën në përkrahje të këtyre protestave të kolegëve të tyre në Kosovë për t'i kërkuar të drejtat elementare të punës. Mes tjerash, sindikalistët e Unia kërkuar edhe ndërprerjen e diskriminimit gjinor dhe trajtimin e barabartë për gratë në vendet e punës.

«Gratë janë ato që diskriminohet në mënyra të shumfishta, apo dyfishtë. Sa i përket pa barazisë në paga dhe

në Zvicër fitojmë 20 për qind më pak. Mirëpo grat përpos diskriminimit në paga, përjetojnë edhe diskriminime tjera, ngacmim seksual, trajtim jo të barabartë të pagesës dhe gjithë ne duhet të solidarizohemi dhe të kërkojmë barazi me to, si dhe për një të ardhme më të mirë të gjeneratave tona të përbashkëta dhe të bashkuar ti kundërvihemi neoliberalizmit, neo-kolonializmit dhe patriarkatit.» Shtoi nder të tjera ai.

«Në Zvicër, por edhe në Evropë janë duke fryrë era të populistëve të djathtë të cilët shërbehen me stigmatizimin e të huajve për ta përkeqësuar ligjin jo vetëm karshi të huajve dhe emigrantëve, por dhe pagave të punëtorëve. Njëri nga aspektet kryesore përpos përkeqësimit të ligjit për të huajt, krijimit të një drejtësie dy-klasëshe gjithashtu lëvizja e lirë e njerëzve si një e drejtë elementare është e kufizuar. Më shumë ka të drejtë kapitali dhe ndërmarrjet të barten prej një vendi në një vend ndërsa njerëzit jo», tha Mattia Lento.

### Apeli i kryetarit të Sindikatës së re të KEK-ut, Nexhat Llumnica

Kryetari i Sindikatës së Re të KEK-ut, Nexhat Llumnica, kritikoi ligjin për paga. Ai theksoi se sipas ligjit të iniciuar nga Qeveria e Kosovës, miratuar nga Kuvendi i Kosovës, punëtorët e KEK-ut duhet të punojmë vetëm nga ora 07:00 deri në ora 15:00. Por, ai thotë se sikur të ndodhte një gjë e tillë, Qeveria dhe institucionet e vendit do të mbeteshin në terr.

«Unë ju bëj thirrje dhe ju bëj me dije ashtu siç i kemi bërë Avokatit të Popullit i cili e ka të drejtën të dërgojë në Gjykatën Kushtetuese, amendamentet ku përfshihemi edhe ne ndërmarrjet publike të ligjit për paga. Ju bëj thirrje institucioneve që të mendojnë për punëtorin, mos të vijmë para votave dhe të na lusin se çka po kërkontë se atëherë është vonë», tha Llumnica.

### Pjesët kreative të protestës

Derisa Organizata Studim-Kritikë-Verprim, në shenjë proteste, ka vendosur para objektit të qeverisë 31 helmata,



Mattia Lento gjatë fjalës së tij

në kujtim të 31 punëtorëve që humbur jetën në vendet e punës.

Pjesë kreative e protestës ishte edhe ajo e punëtorëve të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Ata në fund të protestës u ndanë dhe u dhuruan certifikata ironizuese zyrtarëve më të lartë të vendit, ndër të tjera si në vijim: «për nepotizëm, për ndihmë punëdhënësve, për zvogëlimin e pagave dhe vendeve të punës, për gënjeshtra, për mosrespektimin e të drejtave të punës, për ulje të standardeve të punëtorëve me ligj për paga».

### Protesta e shoqërisë civile

Protestë gjithëpërfshirëse e thirrur prej grupeve dhe organizatave të ndryshme të spekitit të gjerë shoqëror, si Qendra Sabota, Rrjeti i Grave të Kosovës, Termokiss, Kongresi Kombëtar i të Rinjve Kosovë. Në këtë organizim heterogjen, grupet/organizatat e ndryshme kanë bërë thirrjet e tyre për çështjet relevante për ta. Marshuta e kësaj protestës dinamike ishte: Amfiteatri i Sheshit Zahir Pajaziti, Ministria e punës, Policia, Kino ABC, BSPK, Inspektorati i Punës, Teatri Kombëtar, Qeveria, Amfiteatri te Sheshi Zahir Pajaziti.

«Duam kontrata», «sigurim shëndetësor në punë», «jo orë pune pa pagesë», «poshtë inspektorati i korruptuar», «poshtë bankat e fajdes» ishin vetëm disa nga parullat që dolën nga protesta e 1 majit ku po mbanim pankarta me kërkesa për të drejta shoqërore, për jetë më të dinjitetshme dhe kundër kapitalizmit e patriarkatit.

Osman Osmani